



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot

Patos, më 10/08/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I. OBJEKTI I PROKURIMIT: “Krijimi i parkut rekreativ në Lagjen e Re”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punë ndërtimore 45.

VLERA E FONDIT LIMIT: 33,474,054.47 (tridhjetë e tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e katër pikë dyzet e shtatë) lekë pa TVSH, 40,168,865.36 (dyzet milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë me TVSH vënë në dispozicion nga burimet e veta të bashkisë dhe grandit në bazë performance për vitet 2026-2028 për objektin: “Krijimi i parkut rekreativ në Lagjen e Re”.

Nga të cilat:

4,301,692 (katër milion e treqind e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH nga grandit në bazë performance për vitin 2026

8,247,013.37 (tetë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e trembëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH nga burimet e veta të bashkisë për vitin 2026

4,166,666.6 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë) lekë pa TVSH nga burimet e veta të bashkisë për vitin për vitin 2027

16,758,682.5 (gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy pikë pesë) lekë pa TVSH nga burimet e veta të bashkisë për vitin për vitin 2028.

Kontraktori është i detyruar të përfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve përkatëse.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar)

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **33,474,054.47 (tridhjetë e tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e katër pikë dyzet e shtatë) lekë.** (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Fondi limit = 33,474,054.47 (tridhjetë e tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e katër pikë dyzet e shtatë) lekë pa TVSH.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të

Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të balanceve të viteve financiare 2023,2024, 2025 të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".(i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor kështu e maturuara për vitin 2026, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026..

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kesteve ,prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose **16,737,027.24 lekë**
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohe ose **33,474,054.47 lekë**

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. *Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

2.3.1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);

- Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
 - Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore.
- 2.3.2** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 2.3.3** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.4 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë, në bazë të VKM Nr. 42 dt 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

NP-1: Punime gërmimi në tokë Kategoria “A”

NP-2: Ndërtime civile dhe industriale Kategoria “A”

NP-3: Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada Kategoria “A”

NP-11: Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë Kategoria “A”

N.S-1: Punime për prishjen e ndërtimeve
NS-18 Punime topogjeodezike

Kategoria “A”
Kategoria “A”

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi, ose ekuivalente të licensave profesionale për operatorët e huaj.

Në rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategorite e licences sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

➤ **NP-1: Punime gjurmimi në tokë**

Kategoria “A”

Konsiderohen gjurmimet, sistemet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohej vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

➤ **NP-2: Ndërtime civile dhe industriale.**

Kategoria “A”

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazërma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

➤ **NP-11 Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë**

Kategoria “A”

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

➤ **N.S – 1 Punime për prishjen e ndërtimeve**

Kategoria “A”

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

➤ **N.S - 18 Punime topogjeodezike**

Kategoria “A”

Konsiderohet zbatimi i rrethimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar	Vlera e punimeve që parashikohen
---------------------	--	--	---------------------------------	----------------------------------

			për kategorinë respektive	të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë	- Germim dheu themele e plinta me $b > 2m$, ekskavator me goma $0.25m^3$, shkarkimi ne toke - Germim dheu me ekskavator zingjir $0.25 m^3$, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet - Germim dheu themele e plinta me $b > 2m$, ekskavator me goma $0.25m^3$, shkarkimi ne toke - Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III - Germim kanalesh ne toke te bute, me krahe, me seksion deri $0.75 m^2 >$	Kategoria A	0-20 milion lekë
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	- Shtrese betoni C 12/15 - Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri - Struktura monolite betoni C 16/20 - Struktura monolite betoni C 20/25 - Struktura monolite betoni C 6/10 - Struktura monolite betoni C 20/25 - Struktura monolite betoni C 25/30 - F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm - F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm - Plinta e bazamente b/a monolite deri $20m^3$ C 16/20 - F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm - Struktura monolite betoni C 20/25	Kategoria B	21-50 milion lekë
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	- Suvatim me grafiato $h > 4 m$ - Boje hidroplastike cilesi e larte - Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama	Kategoria A	0-20 milion lekë
NP-11	Ndërtime për nënstationet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	- F.V. Shtylla te centrifuguara B. A. C25/30 per linja 0.4-10 kv, me traktor, ndermjetese, NH- 6 m, 130/210/4 - F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, $4 \times 50mm^2$ - F.V Qafore linje me dy krah $D=220 mm$ - FV.Tirantues linje $4 \times (16 \div -70)mm^2$ - FV Morsete al-al 50 - Aksesorë lidhjeje (izolatorë, klema, kapëse, etj.) - Prozhektor LED 200 Ë, IP66, 5700K - Shtyllë ndriçimi 9 m, galvanizuar	Kategoria A	0-20 milion lekë

		- Kabllo NYY 3×6 mm² - Tub HDPE Ø40–50 mm - F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm - F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement - F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm - F.V. Percjelles PV-500 Ø 6 mm² - F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm² - F.V. Automat magneto-termik 220V,10A, 2P - F.V. Percjelles PV-500 Ø 10 mm² - Ndriçues LED TIP "SEMPIONE" 150Ë (ose i ngjashëm) - Shtyllë ndriçimi metalike konike (sipas projektit) - F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 20x20x20cm		
NS-1	Punime prishjen ndërtimeve për e	- Çmotim, Spostim shtylla ekzistuese (perfshi linjen) - Prishje suvatim i jashtem - Prishje e hidroizolimit ekzistues (tarrace) - Prishje shtresa betoni - Prishje mure betoni - Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	Kategoria A	0-20 milion lekë
NS-18	Punime topogjeodezike	- Shtrese zhavori lumi t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese zhavor lumi t=20cm - F.V. Fidane Lule dekorative - F.V. Fidane Peme dekorative - Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka - Mbushje me cakell pas mureve - Mbushje me zhavorr pas mureve - Shtresë me beton C30/37 të përforcuar me rërë kuarci, me ngjyrosje akrilike per terrene sportive - F.V. kosh basketbolli komplet, me strukturë metalike të galvanizuar fiksuar në bazament betoni, tabelë akrilike 180×105 cm, rreth çeliku standard dhe rrjetë najloni. - F.V. portë kalçeto 3×2 m e ndërtuar me konstruksion hekuri tubolar rrethor Ø76 mm, e salduar dhe e lyer me primer + 2 shtresa boje sintetike, e pajisur me rrjetë najloni. - F.V. komplet i pajisjeve të fushës së volejbollit, përfshirë shtylla çeliku galvanizuar Ø80 mm me mekanizëm tensionimi, bazament betoni , rrjetë standarde 9.5 × 1 m.	Kategoria A	0-20 milion lekë

		- Stol parku 2.5 m me bazament betoni dhe binare druri - Shtresë druri 200×45×2 cm, prej druri pishe të trajtuar për ambient të jashtëm, e fiksuar mbi binarë druri 50×70 mm çdo 45 cm, me vida inox - F.V Kosh mbeturinash, metalik, për ambient të jashtëm - Shtrese betoni me ngjyre - Nenshtrese zhavori - Shtrese betoni C 12/15 - Shtrese rere - Shtrese betoni C 12/15 - Nenshtrese zhavori - F.V. Bordura betoni 12x25cm - F.V. Bordura betoni 12x25cm - Mbjellje bari në skarpat - F.V. Fidane Peme dekorative - F.V. Fidane Lule dekorative - Pergatitje e vendosje lende e sharruar - Panele derrase për skele - Boje vaji sipërfaqe druri - F.V Kosh mbeturinash, metalik, për ambient të jashtëm - Stol parku 2.5 m me konstruksion çeliku/gize të lyer me bojë pluhuri, ulëse dhe mbështetëse prej dërrasash druri të trajtuara për ambient të jashtëm, me tre mbajtëse metalike; përfshirë gërmimin me krahë, realizimin e bazamentit betoni C20/25, vendosjen, nivelimin dhe fiksimin në vend - Gazebo druri si në projekt - Tra ekuilibri - Shilarese druri - Shtrim me pllka betoni 6cm - Shtrim me pllka betoni 6cm - F.V. Gjeotekstil 165g/m² - Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize - F.V. Tuba të brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm		
--	--	---	--	--

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të leshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike të ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kushtë s'kualifikues.

2.5 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.
- d) CV (perkatëse)

Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesë të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë për sipas përqindjes së bashkepunimit.

Shenim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë AK, përpara publikimit të njoftimit fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

2.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist
- 1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder

2.6.1 Në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Për këtë duhet të paraqesë

- Kontrate pune të vlefshme,
 - Diplomë,
 - Librezë pune,
 - CV përkatëse,
 - si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- a) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zërave të preventivit të punimeve si më poshtë:
- Inxhinier mjedisi 1 (një)

Për këtë duhet te paraqesë

- Kontrate pune te vlefshme,
- Diplomë,
- Libreze pune,
- CV perkatese,
- si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

(Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit)

***Shënim:** Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të pare, prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jete nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.*

2.7 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe staf (jo domosdoshmerisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **1 (një) person i certifikuar si Specialist për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të ndërtimit/Inxhinier Materialeve**

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Per secilin pesetar te stafit te mesiperm duhet te paraqese:

- Kontrate pune te vlefshme
- Diplome
- Libreze pune
- CV perkatese
- Si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

2.8 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- a) 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, njeri prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë")*.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

- b) 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë "Ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", neni 49, pika 4.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Në rastin kur eksperti zjarrfikës është i kontraktuar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/Certifikatë
- Marrëveshje bashkëpunimi

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.9 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër të punësuarish mesatar të paktën 35 (tridhjetë e pesë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.
- b. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar,

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2.9.1 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave:

Punonjës Staf Teknik

- 1 (një) Teknik ndertimi,
- 1 (një) punonjes hidraulik
- 1 (një) punonjes elektrikist
- 2 (dy) hekurkthyes
- 2 (dy) karpentier
- 1 (nje) punonjës saldator,
- 1 (një) punonjës montator (per konstruksionet metalike)
- 1 (një) suvatues
- 1 (një) betonues
- 1 (nje) hidroizolues
- 2 (dy) pllakashtrues (pllaka trotuari)
- 1 (një)) punonjes bojaxhi
- 10 (dhjete) punëtor të thjeshte

Punonjës Manovrator (shofer)

- 3 (tre) shofer kategoria C
- 1 (një) Eskavatorist
- 1 (një) Buldozerist
- 3 (tre) Automakinist

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- a. kontratën individuale të punës te vlefshme;*
- b. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;*
- c. Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione (shteterore apo private) te licencuara/akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise”Deshmi te Sigurimit Teknik e leshuar nga ISHTI ose nga nje grup certifikues e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.*

Për punonjësit eskavatorist, buldozerist dhe automakinist ofertuesi duhet të paraqesë:

- *kontratën individuale të punës të vlefshme;*
- *leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale(CAP)per shoferet dhe deshmi aftesimi profesional (DAP), (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor per manovratorët-automakinistët/eskavatoristët/buldozerist, që të vërtetojnë kualifikimin profesinonal te kerkuar, referuar rregullores “Per kushtet,kriteret dhe programet per pergatitjen teoriko-praktike te kandidateve, si dhe dhenien e Deshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i perdorimit te tyre, miratuar me urdhër nr. 200,datë 16.5.2019, te Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës .*

(Në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist dhe shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

2.9.2 Per punetoret e thjeshte 10 (dhjete) punëtor ofertuesi duhet të paraqesi :

- Kontratë individuale pune,
- Dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit – Profili Transport** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e segemteve rrugore. Eshte përgjegjes per cilesine e materialeve si cakell, stabilizant, binder dhe asfaltobeton.
- **Inxhinier Gjeodet /Topograf/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve të ndërtimit pjesë e fushës së tij, zbatimin e projektit sipas të gjithë elementëve përkatës topografik.
- **Teknik ndërtimi** (ose ing ndërtimi në zbatim) është përgjegjës për ndjekjen dhe ecurinë e punimeve në kantierin e ndërtimit.
- **Hidraulik** eshte përgjegjes per realizimin e punimeve hidraulike ne tualetet e objektit per furnizimin me uje dhe shkarkimit te ujerave te ndotur sipas projektit.
- **Elektrici** është përgjegjës për realizimin e saktë të punimeve të ndriçimit të rrugës me materialet dhe detajet e specifikuar në projekt.
- **Bojaxhi** është përgjegjës për punimet e lyerjes së fasadës dhe ambienteve të brendshme në objekt.
- **Suvatues** është përgjegjës për suvatimin emureve të rinj dhe riparimin e mureve ekzistues.
- **Saldator** është përgjegjës për saldimin e konstruksionit metalik (shkalle emergjence).
- **Montator** është përgjegjës për montimin e e konstruksionit metalik (shkalle emergjence).
- **Pllakashtrues** është përgjegjës për shtrimin e pllakave të trotuarit sipas projektit
- **Hidroizolues** është përgjegjës për punimet hidroizoluese në solete dhe .
- **Karpentier** është përgjegjës për mbërthimin e saktë të kallëpëve, për realizimin e betonimit të elementëve të ndryshëm në objekt.
- **Betonues** është përgjegjes per realizimin e punimeve te betonit të elementëve të ndryshëm në objekt.
- **Hekurkthyes** është përgjegjes për realizimin e punimeve te hekurit ne elementet si tra, themel, kollone dhe brez b/a.

- **Shofer** janë personat përgjegjës për drejtimin e makinerive në kantiar dhe jashtë kantierit për furnizimin dhe transportin e materialeve të nevojshme për objektin që prokurohet.
- **Manovrator (Eskavatorist, buldozerist)** janë personat përgjegjës për drejtimin e makinerive dhe pajisjeve të ndertimit në kantiar dhe jashtë kantierit për kryerjen e proceseve të caktuara të punëve (psh. presa/pompa betoni, ekskavatore gërmim, mini fadroma, skrep të llojeve të ndryshme etj) të nevojshme për objektin që prokurohet.
- **Automakinist** është përgjegjës për drejtimin e mjeteve që ngrejne ngarkesa në lartësi (autovinç)

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

2.9.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën **35 (tridhjetë e pesë)** personave të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar,

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Referuar kategorisë së punimeve si dhe afatit, stafi i kërkuar duhet të jetë:

• Teknike ndërtimi	1 (një)
• Hidraulik	1 (një)
• Elektriçist	1 (një)
• Hekurkthyes	2 (dy)
• Karpentier	2 (dy)
• Saldator	1 (një)
• Montator (konstruksione metalike)	1 (një)
• Suvatues	1 (një)
• Betonues	1 (një)
• Hidroizolues	1 (një)
• Pllakashtrues (Pllaka trotuari)	2 (dy)
• Bojaxhi	1 (një)
• Punëtor të thjeshtë	10 (dhjetë)
• Drejtuues teknik	2 (dy)

- *Shofer* 3 (tre)
- *Ekskavatorist* 1 (një)
- *Buldozerist* 1 (një)
- *Automakinist* 3 (tre)

TOTALI = 35 (tridhjetë e pesë) Persona ne Staf.

Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplome ose dëshmi kualifikimi
- Kontrata pune
 - a) *Vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatimeve të Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të rrethit përkatës ose me vulë elektronike.*
 - b) *Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

Ne raste kur makineritë dispononohen me qera, këta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si pasojë nuk mund të jenë domosdoshmërisht në listpagesën e shoqërisë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt.

Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Numri dhe kualifikimi i punonjësve të paraqitur në këtë ofertë është përcaktuar në përputhje me mjetet dhe makineritë e deklaruar për realizimin e kontratës. Çdo mjet i parashikuar shoqërohet me personelin përkatës teknik të nevojshëm për operimin e tij, duke garantuar funksionim të pandërprerë dhe efikas gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve. Konkretisht, numri i shoferëve, ekskavatoristëve, buldozeristit dhe automakinistëve është dimensionuar mbi bazën e numrit dhe llojit të makinerive të angazhuara, për të përballuar ngarkesën e punës dhe çdo situatë operative. Kjo qasje garanton një shpërndarje optimale të burimeve njerëzore në raport me kapacitetet teknike, duke rritur sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e realizimit të punimeve në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Në tërësi, këto kërkesa për staf minimal janë të justifikuara nga: Volumi dhe dinamika e punimeve; Nevoja për paralelizëm në procese; Respektimi i afateve kontraktuale; Garantimi i sigurisë në kantier; Cilësia e zbatimit sipas standardeve të ndërtimit të rrugëve.

Prandaj, vendosja e këtyre kritereve në dokumentet e tenderit synon të sigurojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin me sukses të projektit.

Argumentimi teknik :

a) Punime per mobilizimin e kantierit

Këto punime përfshijnë përgatitjen e kantierit per fillimin e punimeve. Gjate kesaj kohe do te percaktohen furnitoret dhe vendet e depozitimit te materialit. Do te strukturohet organika e njerezve që do te punojne ne kantier dhe do te behet konturimi i hyrje daljeve te tij, vendosja e tabelës informuese. Afati i parashikuar eshte 6 dite pune. Puntor te angazhuar jane 6 punetor, 3 shofer dhe 1 manovrator. Makineri Kamion dhe/ose pick-up, dumper, vinç kulle, rimorkiator per sjelljen e makinerive. Nevojiten pajisjet si matrapik, gjenerator, depozite uji dhe pompe uji si dhe autoboti per furnizimin me uje gjate zhvillimit te proceseve te punes.

b) Punime germimi dheu

- | | |
|--|--------------------------------|
| • <i>Volumi i punimeve per germim</i> | <i>1926 m³.</i> |
| • <i>Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve</i> | <i>129 op.</i> |
| • <i>Norma mesatare e punimeve</i> | <i>0.067 op/m³.</i> |
| • <i>Volumi i punimeve per germim</i> | <i>170 m³.</i> |
| • <i>Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve</i> | <i>578 op.</i> |
| • <i>Norma mesatare e punimeve</i> | <i>3.4 op/m³.</i> |

Këto punime përfshijnë germimin e shtresave sipas projektit. Orari nominal mesatar për punimet e germimit është 0.067 op/m³, 3.4 op/m³. Referuar grafikut të punimeve që parashikon afatin me 14 ditë pune. Për kryerjen e këtyre proceseve të punës nevojiten 1 eskavatorist, 2 shofer dhe 10 punëtor të thjeshtë. Makineritë që nevojiten janë 2 kamion me kapacitet mbajtës 10 deri 20 ton per transportin e mbeturinave dhe 1 eskavator me zhinxhir.

c) Punime shtresash

- | | |
|--|-------------------------------|
| • <i>Volumi i punimeve</i> | <i>1506 m²</i> |
| • <i>Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve</i> | <i>208 op</i> |
| • <i>Norma mesatare e punimeve</i> | <i>0.092op/m²</i> |
| • <i>Volumi i punimeve (shtrese cakelli)</i> | <i>288 m²</i> |
| • <i>Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve</i> | <i>345.6 op</i> |
| • <i>Norma mesatare e punimeve</i> | <i>1.2 op/m²</i> |
| • <i>Volumi i punimeve (nenshtrese zhavori)</i> | <i>318.5 m³</i> |
| • <i>Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve</i> | <i>637 op</i> |
| • <i>Norma mesatare e punimeve</i> | <i>2.9 op/m³</i> |
| • <i>Volumi i punimeve (shtrese rëre)</i> | <i>18 m³</i> |
| • <i>Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve</i> | <i>40 op</i> |
| • <i>Norma mesatare e punimeve</i> | <i>2.175 op/m³</i> |
| • <i>Volumi i punimeve (shtresë betoni)</i> | <i>37.2 m³</i> |

- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** 320 op
- **Norma mesatare e punimeve** 8.6 op/m³

Këto punime përfshijnë ndërhyrjen në rehabilitimin e trotuareve të parashikuara dhe krijimin e shesheve . Orari nominal mesatar për punimet shtresave është rreth 0.092-1.2 op/m². Referuar grafikut të punimeve që parashikon afatin me 61 ditë pune. Për zbatimin e këtyre punimeve nevojiten 7 punëtor të thjeshtë, 1 eskavatorist dhe 4 shofer, 1 betonues, 1 karpentier. Makineritë që nevojiten janë pajisje për nivelimin e shtresave 1 Eskavator me goma, 2 kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton dhe 1 kamion me kapacitet mbajtës 10 deri 20 ton, 1 tokmak për ngjeshjen e shtresave, autobetoniere, betoniere 0.25m³,

d) Punime vendosje bordurash

- **Volumi i punimeve** 870 ml
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** 652.5 op
- **Norma mesatare e punimeve** 0.75 op/ml.

Keto punime përfshijne vendosjen e bordurave të parapërgatitura sipas përcaktimeve në projekt. Parashikimi i kohezgjatjes së punimeve 16 dite pune për vendosjen e bordurave të parapërgatitura . Për realizimin e këtyre punimeve në afatin e parashikuar nevojiten 5 punëtor të thjeshtë, 1 betonues (vendosjen e shtresës së betonit për fiksimin e bordurave). Makineri dhe mjete të angazhuara për këtë proces pune: 1 betoniere 0.25 m³, kamionçinë me kapacitet mbajtës 1.2-3.5 ton, autobot uji, depozitë uji min 5000l.

e) Punime betoni dhe betonarmeje

- **Volumi i punimeve** 7.2 m³
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** 50 op
- **Norma mesatare e punimeve** 6.93 op/m³.
- **Volumi i punimeve Zona A** 154 m³
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** 100.1 op
- **Norma mesatare e punimeve** 12.8 op/m³.

Keto punime përfshijne ndertimin e elementeve konstruktiv sipas përcaktimeve në projekt. Parashikimi i kohezgjatjes së punimeve 16 dite pune për punime betoni dhe perpunim hekuri (armim) . Për realizimin e këtyre punimeve në afatin e parashikuar nevojiten 1 hekurthyes dhe 2 betonues, 1 automakinist, 2 shofer, 3 punëtor të thjeshtë. Makineri dhe mjete të angazhuara për këtë proces pune: 1 autovinç, 2 autobetoniere, 1 autopompë betoni, 1 makineri për prerje dhe 1 makineri për kthim hekuri.

f) Punime të ndryshme

- **Volumi i punimeve**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve**
- **Norma mesatare e punimeve**

Keto punime përfshijne vendosjen e shtyllave të ndriçimit, ndërtimin e konstruksioneve metalike të përbëra dhe të thjeshta, vendosja e paneleve me dërrase, lysterja me bojë vaji, vendosja e koshit të mbeturinave apo elementëve të ndryshëm për zbatimin e projektit. Parashikimi i kohezgjatjes

se punimeve është e përfshirë në alternim me punime të tjera në projekt (referuar grafikut të punimeve gjatë 4 muajve). Per realizimin e ketyre punimeve ne afatin e parashikuar nevojiten 10 punëtor të thjeshtë, 1 elektrikist, 1 pllakashtrues (pllaka trotuari), 1 bojaxhi (lyerje me boje vaji), 1 saldator, 1 montator. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 autovinç, 1 kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton, 1 kamion me kapacitet mbajtës 10-20 ton.

g) Punime per demobilizimin e kantierit

Per demobilizimin e kantierit duke qene se jane disa nenobjekte, me perfundimin e secilit nenobjekt behet largimi i makinerive dhe pajisjen nga vendi i ndertimit (kantieri) per dorezimin e punimeve te realizuara eshte parashikuar nje periudhe kohore prej 6 dite pune. Puntore te angazhuar per realizimin ne afat te ketij demobilizimi duhen 1 specialist +1 puntor. Makineri dhe pajisje te nevojshme per kete faze: 1 kamioncine.

Shënim: Argumentimi i nr. të punonjësve bëhet vetëm me qellim për justifikimin e stafit të kërkuar. Ndarja sipas specialiteteve në këtë rubrikë të mos merret në konsideratë në plotësimin e kriterëve të përcaktuara.

2.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetshkarkueskapacitet mbajtës 10-20 ton	Në pronësi ose me qira	copë	3
2	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	copë	1
3	Kamionçine kapaciteti mbajtës 1.2 deri ne 3.5 ton	Në pronësi ose me qira	copë	1
4	Kamion me vinç	Në pronësi ose me qira	copë	1
5	Dumper kantieri	Në pronësi ose me qira	copë	1
6	Eskavator me zinxhir	Në pronësi ose me qira	copë	1
7	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	copë	2
8	Autopomp betoni /Pomp betoni	Në pronësi ose me qira	copë	1
9	Minieskavator	Në pronësi ose me qira	copë	1
10	Rimorkiator per transportin e makinerive	Në pronësi ose me qira	copë	1
11	Rrul (kompresor) me vibrim jo me pak se 7 ton	Në pronësi ose me qira	copë	1
12	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	copë	1
13	Tokmak/ngjeshësh nivelues	Në pronësi ose me qira	copë	1
14	Pompë uji	Në pronësi ose me qira	copë	1
15	Depozite uji min 5000 litra	Në pronësi ose me qira	copë	1
16	Makineri për kthim hekuri ndërtimi	Në pronësi ose me qira	copë	1
17	Makineri për prerje hekuri ndërtimi	Në pronësi ose me qira	copë	1

18	Elektro argano	Në pronësi se me qira	copë	1
19	Fadromë me goma	Në pronësi ose me qira	copë	1
20	Betoniere 0.25 m3	Në pronësi ose me qira	copë	2
21	Matrapik	Në pronësi ose me qira	copë	2
22	Aparat topogjeodezik (GPS ose total Station)	Në pronësi ose me qira	copë	1
23	Makineri vijezi	Në pronësi ose me qira	copë	1
24	Fabrikë betoni e pajisur me leje mjedisore QKL	Në pronësi/qera ose kontratë furnizimi	copë	1

Ne zbatim te VKM-se nr. 312, date 05.05.2010, operatori ekonomik pjesemarres duhet te disponoje mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te puntoreve dhe personelit si me poshte:

- Kokore – jo me pak se 29 cope

- Komplet i ndihmes se shpejte – jo me pak se 3 cope

- Tabela parlatmeruese (HSE) per sigurine ne objekt – jo me pak se 20 cope

a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë);
- leje qarkullimi;
- çertifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme);
- siguracion mjeti (i vlefshëm);
- çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet:

- kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi;
- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
- leje qarkullimi;
- çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
- siguracion mjeti (i vlefshëm);
- çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

d. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

e. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

f. Per mjetet qe nuk shenohen ne rregjistrat publik duhet te paraqiten dokumentat qe vertetojne pronesine e tyre apo marrjen me qira te tij.

- g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- **Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi: Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- **Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi: Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushtron aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek përdoruesit e këtij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- **Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalenten ISO 45001-2023 (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi: *Standarti ISO 45001-2018 është standarde ndërkombëtare, të cilët parashtrojnë kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Të dy ofrojnë udhëzime që ju ndihmojnë të hartoni dhe ngrini strukturën e kompanisë suaj mbi sigurinë dhe shëndetin në punë – duke ju dhënë mundësinë të sillni të gjithë kontrollin e duhur dhe proceset në një sistem menaxhimi. Përfitimet Standarti ISO 45001-2018 Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë krijimi i kushtet më të mira të punës në gjitha ndërmarrjet dhe shoqëritë, identifikojnë kërcënimet dhe vendosin kontrollin për menaxhimin e tyre, reduktojnë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproduktive të puntoreve, përfshijnë dhe motivojnë stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune, dëshmojnë përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve të tyre.*

Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundeson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin e punës, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe në mbështetje të natyrës së objektit të prokurimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Referuar udhëzimeve dhe rekomandimeve të APP-së, për zërat në preventive që mund të jetë paraqitur marke/brand, origjinë apo prodhim specifik, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, janë hartuar në përputhje me legjislacionin përkatës për ndërtimet civile dhe infrastrukturore dhe kanë për qëllim të sigurojnë cilësi të qëndrueshme, funksionalitet afatgjatë dhe siguri teknike të punimeve të parashikuara në rikonstrukcionin e rrugëve në njësitë administrative. Për shkak të veçorive të terrenit dhe kushteve klimatike të zonës, janë përfshirë elementë të detajuar. Këto specifikime janë proporcionale me objektin e kontratës, të zbatueshme në praktikë dhe janë hartuar me kujdes për të parandaluar keqzbatimin teknik, për të garantuar jetëgjatësinë e rrugës dhe për të krijuar kushte të sigurta qarkullimi për banorët e zonës.

Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Referuar udhëzimeve dhe rekomandimeve të APP-së, për zërat në preventiv që mund të jetë paraqitur marke/brand, origjinë apo prodhim specifik, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike.

Të gjitha zërat e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Në rast se në një nga zërat e preventivit është shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.

Specifikimet teknike u hartuan nga “Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile” duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **26/08/2026, ora 11:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Krijimi i parkut rekreativ në Lagjen e Re”**.

NJËSIA E PROKURIMIT

Florian Kita

Boreta Murati

Imela Halimi